Aksesi i Komuniteteve në Shërbimet Publike Mjedisore dhe Menaxhimin e Ujërave Durrës



Ky botim është mundësuar nga një grant i REC në kuadër të programit SENIOR-A "Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri", i cili financohet nga Qeveria Suedeze.

Mirënjohje

Rrjeti “Sot për të Ardhmen” shpreh mirënjohjen ndaj REC Albania për mbështetjen nëpërmjet programit SENIOR-A, Qeverinë Suedeze që bëri të mundur funksionimin e Rrjetit të Shërbimeve Mjedisore për vendosjen e standarteve në nismat kombëtare për mbrojtjen e mjedisit, Institutin e Kërkimeve Urbane, si lider i rrjetit, për ekspertizën e profesionizmin në fushë, si dhe sinergjinë e partnerëve të rrjetit. Partneriteti në këtë rrjet me fokus kryesor menaxhimin e shërbimeve mjedisore, ka shërbyer jo vetëm për njohjen e situatës konkrete, por dhe për forcimin e rolit të vetë rrjetit, ndërgjegjësimin publik për këto çështje dhe shkëmbimin dhe promovimin e nismave konkrete në rajone të ndryshme të Shqipërisë, e në rang kombëtar.

Nëpërmjet këtij rrjeti,“Sot për të Ardhmen”, një organizatë me bazë komunitare arriti të zgjerojë spektrin e angazhimit në çështjet mjedisore dhe fuqizoi jo vetëm aksesin e programeve mjedisore në përfshirjen dhe mobilizimin qytetar, por krijoi dhe sinergji në një proces me përfitime konkrete publike në menaxhim mjedisor, edukim qytetar, punësim, kushte të përmirësuara të jetesës dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Falenderojmë Bashkinë, Prefekturën, Këshillin e Qarkut Durrës si dhe Ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizimeve për angazhimin e tyre në hartimin e planeve vendore të shërbimeve publike duke marrë parasysh opinionin qytetar dhe rekomandimet e dala nga monitorimi i shërbimeve mjedisore dhe vlerësimi i aksesit në furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura, të kryer nga “Sot për të Ardhmen”.

Një falenderim të veçantë i kushtohet të gjithë vullnetarëve të pasionuar, të angazhuar në monitorim në terren, të rinjve e fëmijëve të talentuar, të angazhuar në veprimtari ricikluese dhe edukim mjedisor, grupeve komunitare që morën pjesë aktive në fushatat e pastrimit, ndërgjegjësimit qytetar, krijimin e ambienteve mjedisore komunitare, si dhe për mendimet dhe sugjerimet e dhëna në seanca dëgjimore me institucionet përkatëse.

Parathënie

Ky botim vjen si rezultat i një pune dyvjeçare të “Sot për të Ardhmen” në kuadrin e Rrjetit të Shërbimeve Mjedisore në Shqipëri, drejtuar nga URI (Programi SENIOR-A), në monitorimin e opinionit qytetar mbi shërbimet mjedisore në Durrës, kampionimin e ujit të pijshëm dhe më pas në vlerësimin e aksesit në furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujrave të ndotura në zonën funksionale Durrës. Është e rëndësishme të përmendet që diskutimet dhe rekomandimet janë bërë në përqasjen komunitet – qeveri – shoqëri civile. Të gjitha përfundimet dhe rekomandimet e dala nga monitorimet në zonën funksionale Durrës janë në këtë botim për t’i shërbyer nismave për mbrojtjen e mjedisit.
Me anë të këtij botimi, “Sot për të Ardhmen” kontribuon në zgjerimin dhe unifikimin e nismave mjedisore, furnizimin me informacion të përditësuar për qeverisjen qendrore dhe vendore, si dhe ndihmon në planifikimin dhe zhvillimin e projekteve për përrmirësimin e kushteve të jetesës së komuniteteve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Roli dhe rëndësia qytetare në çështjet mjedisore

Gjatë vrapit për t'u integruar, shoqëria shqiptare është përballur me faktorët si emigrimi dhe migrimi, papunësia, shkatërrimi në masë, mosfunksionimi i sistemit në tërësi dhe i shërbimeve publike në veçanti, të cilat dëmtuan mjedisin, duke filluar nga dhunimi dhe shkatërrimi i hapësirave publike, deri në mikrohapësirat rrethuese. Krahas hallkave të tjera kyçe në kuadrin e përgjithshëm rregullator mjedisor, përfshirja dhe angazhimi qytetar është i rëndësishëm për adresimin, ndërhyrjen dhe reduktimin e problemeve mjedisore. Ndërgjegjësimi qytetar duhet të kanalizohet drejt motivimit dhe edukimit të qëndrimeve individuale dhe shoqërore ndaj mjedisit, si një cikël i vazhdueshëm bazuar dhe përshtatur në të dhëna konkrete dhe periodike.

Mbrojtja e mjedisit e ndërthurur me mirëqeverisjen dhe shërbimet komunitare janë prioritete të "Sot për të Ardhmen" jo vetëm në Durrës, por dhe në rajone të tjera të Shqipërisë. "Sot për të Ardhmen" është në rrjetin e shërbimeve mjedisore të SENIOR-A, pikërisht për punën dhe angazhimin në drejtim të mbrojtjes dhe shërbimeve mjedisore, si mediator i komuniteteve në qeverisjen vendore.

Vlen të përmendet që përfshirja e komuniteteve, institucioneve, shoqërisë civile dhe sektorit privat në këtë proces është gjithëpërfshirës. Përmes angazhimit dhe mobilizimit qytetar në veprimtari konkrete, del në pah rëndësia e rolit të komuniteteve në zbatimin e politikave dhe për rritjen e cilësisë së shërbimeve mjedisore.

SENiOR-A

Programi "Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri 2012-2015, SENiOR-A", zbatohet nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri dhe financohet nga Qeveria Suedeze dhe ka si qëllim të përgjithshëm "Forcimin dhe specializimin e mëtejshëm të shoqërisë civile në fushën e mjedisit në Shqipëri, për të qenë e aftë të paraqesë nevojat e komunitetit, të sigurojë shërbime e mbështetje, të zhvillojë partneritete dhe rrjete të përbashkëta, të adresojë përparësitë kombëtare të zhvillimit në fushën e mjedisit dhe udhëheqë në rrugën drejt zhvillimit të qëndrueshëm".

Projekti "Shoqëri Civile Aktive në Mbështetje të Objektivave Kombëtarë në Fushën e Menaxhimit të Shërbimeve Mjedisore" ka për synim promovimin e një rrjeti të përgatitur në fushën e menaxhimit te shërbimeve mjedisore nëpërmjet veprimeve të përbashkëta vendore, rajonale, qëndrore që nxisin përmirësimin e situatave të evidentuara.

Grupimi i organizatave të shoqërisë civile "Instituti i Kërkimeve Urbane" (URI), "AULEDA" Vlore, "Tjetër Vizion" Elbasan, Fondacioni "Gjirokastra" Gjirokastër, "Unë, Gruaja" Pogradec, "Sot për të Ardhmen" Durrës, në këtë rrjet me fokus kryesor menaxhimin e shërbimeve mjedisore, në të cilin URI është organizata lider, do të shërbejë jo vetëm për njohjen e situatës konkrete, por dhe për forcimin e rolit të vete rrjetit, ndërgjegjësimin publik për këto çështje dhe shkëmbimin dhe promovimin e nismave konkrete në rajone të ndryshme të Shqipërisë, e në rang kombëtar.

KEEP
ALM
RIDE
BIKE

Sot për të Ardhmen

"Sot për të Ardhmen" është rrjet lider në Shqipëri për mobilizim dhe fuqizim të komuniteteve në nevojë. Udhëhequr nga vizioni dhe duke përdorur metoda inovative dhe gjithëpërfshirëse, "Sot për të Ardhmen" ka krijuar përqasje të suksesshme të fuqizimit gjinor; vullnetarizmit; aktivizmit; mbrojtjes së mjedisit; ndërmjetësimit për punësim; shërbimeve, përfshirjes dhe mobilizimit komunitar, duke startuar me punën e saj për ndërgjegjësimin dhe aksione qytetare masive mjedisore në zonën e ish-Kënetës Durrës, një zonë informale me një popullësi rreth 60,000 banorë, në periferi të Durrësit, e karakterizuar nga popullësi e përbërë nga minoritete të ndryshme dhe krijuar nga fenomeni i migrimit të brendshëm, me nevoja të mëdha në infrastrukturë, legalizim ndërtimesh, shërbime publike, në partneritet të ngushtë me qeverisjen qendrore dhe vendore, agjensitë kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat.

"Sot për të Ardhmen" ka tre qendra të rëndësishme në Tiranë, Durrës dhe Pukë, si dhe ka shtrirje kombëtare me programet e tij në Shkodër, Pukë, Lezhë, Burrel, Durrës, Tiranë, Elbasan dhe Korçë, si dhe bashkëpunon me partnerët e tij dhe qeverisjen vendore në Kukës, Peshkopi, Librazhd, Pogradec, Fier, Berat, Vlorë, Gjirokastër dhe Sarandë.

Prej gati 18 vitesh fokusi i punës përqendrohet në mobilizimin e komunitetit, nxitjen e vullnetarizmit dhe rrjetëzimin e grupeve dhe nismave komunitare. Qendrat ofrojnë një sërë shërbimesh për të rinjtë, fëmijët, gratë, të moshuarit, minoritetet, kurse profesionale dhe ndërmjetësim punësimi, ndërgjegjësim dhe sensibilizim për të drejtat e njeriut, aktivitete sociale integruese, kurse kundër analfabetizmit, seminare dhe trajnime për çështje të ndryshme, edukative, të shëndetit, aksione dhe ndërgjegjësim për mbrojtjen e mjedisit, legalizimin e ndërtesave informale, përmirësimin e shërbimeve publike lokale, si dhe mbi nevojat dhe përfitimet e vullnetarizmit në komunitet.

Që nga viti 2014 "Sot për të Ardhmen" është anëtar i Rrjetit të Shërbimeve Mjedisore. Roli i saj është i fokusuar në ndërgjegjësimin qytetar në rajonin e Durrësit duke sjellë praktikën lokale në nivel kombëtar. Në këtë kuadër, përveç punës për ndërgjegjësimin publik, "Sot për të Ardhmen" fokusohet në koordininimin me qeverisjen vendore dhe institucionet publike për të nxitur veprime dhe aksione që kontribuojnë në përmirësimin e situatës mje

disore, organizimit të debateve dhe seancave dëgjimore komunitet-qeverisje, si dhe analizave dhe monitorimeve të shërbimeve mjedisore, situatës mjedisore dhe dhënies së rekomandimeve. Këto janë pasqyruar nëpërmjet tryezave të rrumbullakta, bashkërendimit me partnerët e rrjetit, konferencave dhe publikimeve të ndryshme, të cilat u paraqiten qeverisjes vendore, institucioneve të referencës, shoqërisë civile dhe qytetarëve, për të nxitur dhe promovuar angazhimin e tyre në prioritetet mjedisore në nivel rajonal dhe kombëtar.

Gama e veprimtarisë së rrjetit "Sot për të Ardhmen" është e gjerë dhe përfshin edukimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit nëpërmjet fushatave mjedisore masive, seminareve mjedisore, edukimit mjedisor, aksioneve në komunitet dhe veprimtarisë ricikluese. Disa nga praktikat e realizuara në këtë drejtim nga QZHK "Sot për të Ardhmen" janë fushatat e ndërmarra si: pedalim, pastrim zone të plazhit, pastrim i zonës së ish-kënetës, krijimi i parqeve me mbetje të ricikluesshme, vendosja e koshave të diferencuar, edukim mjedisor i të rinjve dhe i mësuesve të shkollave të mesme etj., krahas koordinimit me Bashkinë, Qarkun dhe Prefekturën dhe institucionet e referencës në lidhje me shërbimet mjedisore.

Studimet: Zona e mbulimit

Qyteti i Durrësit është një ndër qytetet e mëdha të Mesdheut të lashtë dhe mesjetar i ndërtuar në shekujt XIII-XI p.e.s. Durrësi është një qytet me kulturë të hershme, për vetë origjinën e tij të lashtë. Qyteti ka trashëguar mjaft vlera të së kaluarës, qendra historike dhe arkeologjike si amfiteatri, rrethoja bizantine, torra veneciane, muri rrethues i kalasë, por edhe qendra kulturore e fetare si rrënojat e Bazilikës në Arapaj, kështjella e Rodonit etj.

Qarku i Durrësit, sipas INSTAT, ne vitin 2015 ka një popullsi rreth 276.191 banorë në total. Popullsia urbane është 229.641 banorë, ndërsa popullsia rurale 46.550 banorë. Qarku i Durrësit është një nga qarqet që ka përjetuar lëvizjet më të mëdha demografike kryesisht në vitet '90. Këto lëvizje migratore u shoqëruan edhe me probleme të mëdha sociale si vështirësitë e integrimit të popullsisë migratore në jetën sociale të Durrësit, arsimi, shërbimet sociale, kulturore; probleme dhe pamjaftueshmëri e infrastrukturës për t'iu përgjigjur rritjes së popullësisë si në rrjetin rrugor, rrjetin energjetik, të furnizimit me ujë të pijshëm apo të largimit të ujrave të zeza, rritje të konsiderueshme të nivelit të ndotjes së ajrit, probleme me zënien e hapësirave publike dhe reduktimin e sipërfaqes së gjelbërt dhe shtimin kaotik me ritme të shpejta të ndërtimeve, administrimin jo të mirë mbeturinave urbane etj.

Durrësi i Ri, apo e njohur si Ish-Këneta, një zonë informale e populluar nga migrimi i brendshëm pas viteve '90 prej 60.000 banorësh, është akoma një vend i ekspozuar ndaj problemeve mjedisore. Një pjesë e popullsisë së saj jeton në kushte të papërshtatshme higjeno-sanitare, si pasojë e mungesës së infrastrukturës së nevojshme (mungesa e sistemit të kanalizimeve të ujrave të zeza, të ujit të pijshëm etj.), situata të cilat kane ndikim jo të vogël në përhapjen e sëmundjeve të llojeve të ndryshme, dhe që përkeqësohen me situata të tjera që lidhen me keqmenaxhimin e mbetjeve, mungesën e aksesit të banorëve/bizneseve në sistemin e kanalizimeve dhe derdhje të ujërave të ndotura në rrymat ujore, moskujdesjes ndaj hapësirave publike, ndotjet e mjedisit urban tej normave të lejuara etj.
Durrësi, duke qenë një rajon kyç jo vetëm për përqëndrimin dhe diversitetin e popullësisë, por dhe rëndësinë historike, kulturore dhe impaktin që ka në zhvillimin e turizmit shqiptar, është e nevojshme që planet e administrimit vendor për mbrojtjen dhe shërbimet mjedisore t'u përgjigjen kërkesave të rajonit dhe progresit social, ekonomik të tij.

RRJETI	
Instituti i Kerkimeve Urbane	Tiranë
QZHK “Sot per të Ardhmen”	Durrës
“Tjetër Vizion”	Elbasan
“Auleda”	Vlorë
Une, Gruaja	Pogradec
Fondacioni “Gjirokastra”	Gjirokastër

Harta e Rrjetit



Qëllimi

dhe Metodologjia e Studimeve

Megjithë theksin e veçantë që i është vënë vitet e fundit decentralizimit dhe zhvillimit të komunitetit në Shqipëri, akoma në nivel vendor ekziston një transparencë, përgjithshmëri dhe pjesëmarrje e kufizuar e publikut në proçeset vendimmarrëse. Informimi i publikut dhe proçeset e konsultimit janë përgjithësisht të kufizuara dhe ekziston një pjesëmarrje e ulët në diskutimin e çështjeve bazë të qeverisjes vendore siç është: vendosja e prioriteteve, formulimi i politikave dhe strategjive, shërbimeve të ofruara nga bashkitë, etj.

Qëllimi i studimit të parë ***"Vlerësimi aktual i shërbimeve mjedisore"*** është vlerësimi i performancës së shërbimeve të ofruara nga qyteti i Durrësit. Studimi synon gjithashtu të identifikojë problemet reale në fushën mjedisore, si dhe të ndihmojë të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit e bashkisë për të përcaktuar prioritetet në mënyrë që të planifikojnë dhe zbatojnë projektet dhe investimet për përmirësimin e shërbimeve bazë, bazuar në opinionet e qytetarëve.

Gjatë fazës së parë të projektit të mbështetur nga REC dhe nga kërkimi nëpër institucione lokale dhe qëndrore u konstatua që mungojnë të dhëna/matje teknike të krahasueshme për çdo rajon lidhur me këto probleme, ndërkohë që nuk ka plane veprimi të qarta që përfshijnë edhe shoqërinë civile, në zbatim edhe të kërkesave të reja ligjore. Mungojnë bashkëpunimet ndërmjet NjQV/rajoneve për zgjidhje bashkëvendore, si dhe shkëmbimet e përvojave dhe nismave civile në këtë drejtim. Gjithashtu mungojnë edhe metodat e thjeshta që angazhojnë shoqërinë civile për t'u grupuar dhe reaguar në lidhje me përmirësimin e shërbimeve mjedisore në përmbushje të detyrimeve ligjore.

Në këtë kuadër nuk janë të institucionalizuara apo të parashikuara si pjesë e përmirësimit të shërbimit, fushatat

MBËSHTETJE PËR SHËRBIMET
MJEDISORE, DUR
SENiO

e informimit dhe ndërgjegjësimit të banorëve dhe menaxherëve përgjegjës për përmirësim të situatave, si dhe përfshirja e këtyre planeve në strategjitë e NjQV e më tej.

Ky studim bazohet në intervista të drejtpërdrejta, të cilat janë realizuar duke u bazuar në pyetësorë drejtuar qytetarëve. Pyetjet që ishin pjesë e sondazhit, kanë të bëjnë kryesisht me cilësinë e ujit të pijshëm, largimin e ujërave të zeza dhe problematikat që paraqet ky fenomen, menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane, si dhe problematikat qe vijnë në lidhje me zënien e hapësirave publike. Për këtë arsye nga ekspertet e URI-t, u shpërndanë 70 pyetësorë në qytetin e Durrësit dhe u bë një vlerësim dy javor duke zgjedhur familjet në mënyrë të rastësishme për mbushjen e këtyre pyetësorëve, dhe me pas u bë analizimi i të gjitha të dhënave duke nxjerre përfundime në lidhje me cilësinë aktuale të qytetit të Durrësit për problemet e sipërpërmendura.

Duke qënë se nga gjetjet e studimit të parë mbi monitorimin e shërbimeve publike dhe analizimin e kampionit te ujit, shërbimet e ujit të pijshëm dhe largimi i ujrave të ndotura, rezultoi si domosdoshmëri nje monitorim i dytë i detajuar.

Studimi i dytë ***"Niveli i aksesit dhe ofrimit të shërbimit për ujin e pijshëm dhe largimin e ujrave të ndotura ne zonën funksionale Durrës"*** na siguron të dhëna në lidhje me aksesin në furnizimin me ujë të pijshëm dhe cilësinë e ujit, pasi janë pak të njohura problematikat e ujit lidhur me cilësinë e tij dhe qytetarët nuk kanë informacionin e nevojshëm për shërbimet e ujit. Në Qarkun e Durrësit janë shpërndarë në total 100 pyetësorë, si në zonën e Ish Këmetës në zonën e Plazhit, Porto Romano, Nishtullë, Qendër Durrës, në komunën e Maminasit, Sukthit, Rrashbullit, Ishmit dhe Katundit të Ri. Të intervistuarit janë qytetarë dhe banorë të lagjeve respektive, dhe janë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme. Pyetësorët u përqëndruan në marrjen e opinionit qytetar mbi cilësinë e shërbimeve mjedisore si: Furnizimi me ujë të pijshëm, Cilësia e ujit, Largimi i ujrave të zeza. Gjithashtu për të realizuar anketimin e shërbimeve të ujit janë përpunuar të dhënat e 6 Njësive Administrative të Zonës Funksionale Durrës dhe Ndërmarrjet e Ujësjelles Kanalizimet Përkatëse.

Vlerësimi i Opinionit Qytetar mbi Shërbimet Mjedisore Durrës - Rezultatet

1.1.Furnizimi me ujë të pijshëm

Kur u pyeten në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm, *(grafiku 1),* 56% e qytetarëve të intervistuarve janë përgjigjur se kanë çezma brenda shtëpisë, 34% e tyre furnizohen me çezmë në oborr, 9% në mënyra të tjera dhe vetëm 1% me pus.

Për sa i përket sasisë së orëve gjatë të cilave banorët furnizohen me ujë të pijshëm, *(grafiku 2),* 53% e të intervistuarve thonë se furnizohen me ujë 3-4 orë në ditë, 46% e të anketuarve u përgjigjën se furnizohen me ujë të pijshëm vetëm 1 deri në 2 orë në ditë dhe vetëm 1% furnizohen me ujë më shumë se 4 orë në ditë.

Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me erën e keqe të ujit, *(grafiku 3)* 45% janë përgjigjur pak herë, 18% e të intervistuarve janë përgjigjur se ka shumë

1. Si furnizoheni aktualisht me Ujë



2. Sa orë në ditë furnizoheni me ujë



3. Erë e keqe e ujit



4. Shije e keqe e ujit



raste të cilat ata ndjejnë se uji ka erë të keqe, 15% janë pa përgjigje, 11% e të intervistuarve janë përgjigjur se ka gjithmonë raste të ujit me erë të keqe, 6% nuk e dinë dhe 5% janë përgjigjur se ka 1deri në 2 raste të izoluara.

Në rastin kur banorët janë pyetur në lidhje me shijen e keqe të ujit, *(grafiku 4)* 45% e të intervistuarve janë përgjigjur se ka pak raste të ujit me shije të keqe, 22% janë pa përgjigje, 15% janë përgjigjur shumë herë, 9% e të intervistuarve janë përgjigjur se ka gjithmonë raste të ujit me shije të keqe, 9% janë përgjigjur 1deri në 2 raste të izoluara dhe 5% nuk e dinë.

Në rastin kur banorët janë pyetur në lidhje me ujin me ngjyrë të turbullt, *(grafiku 5)* 33% e të intervistuarve janë përgjigjur se ka pak raste të ujit me ngjyrë të turbullt, 25% janë pa përgjigje, 18% janë përgjigjur se ka 1deri në 2 raste të izoluara, 14% e të intervistuarve janë përgjigjur se ka shumë raste të ujit me ngjyrë të turbullt,8% nuk e dinë dhe 2% janë përgjigjur se ka gjithmonë raste të ujit me ngjyrë të turbullt.

Kur banorët janë pyetur në lidhje me ujin me përmbajtje ndryshku, *(grafiku 6),* 32% e të intervistuarve janë pa përgjigje, 25% janë përgjigjur se nuk e dinë, 20% janë përgjigjur se ka pak raste të ujit më përmbajtje ndryshku, 14% janë përgjigjur se ka 1deri në 2 raste të izoluara dhe 9% e të intervistuarve kanë thënë se ka shumë raste të ujit me përmbajtje ndryshku.

5. Ujë me ngjyrë i turbullt



6. Me përmbajtje ndryshku



7. A ka pasur uji ndotje serioze



8. Si ju është bërë i njohur një problem i tillë



Një tjetër seksion i pyetësorit ka qenë qasja e banorëve në largimin e ujërave të zeza. Për pyetjen lidhur me ndotjet serioze të ujit, *(grafiku 7),* 77% e të intervistuarve janë përgjigjur se nuk kanë ndotje serioze të ujit, 19% janë përgjigjur se kanë ndotje serioze të ujit, ndërsa pjesa tjetër janë pa përgjigjje ose nuk e dinë.

Gjithashtu banorët janë pyetur edhe për mënyrën se si u është bërë i njohur ky problem, *(grafiku 8),* dhe 70% të intervistuarve e kanë lënë atë pa përgjigjje, 17% e tyre janë përgjigjur gojarisht nga miq ose të afërm, 4% janë përgjigjur se u është bërë i njohur nga kryetarët e lagjes, 3% nga bashkia, 3% nga media dhe 3% janë përgjigjur se janë përshtypje personale.

1.2. Shërbimi i largimit të ujërave të zeza

Për pyetjen se sa të kënaqur jeni me largimin e ujërave të zeza, *(grafiku 9),* pjesa më e madhe prej 51% janë përgjigjur se nuk janë fare të kënaqur me këtë shërbim, 39% e të intervistuarve janë përgjigjur se janë deri diku të kënaqur, ndërsa pjesa tjetër janë përgjigjur se janë të kënaqur dhe shumë të kënaqur nga ky shërbim.

Nga ana tjetër kur banorët janë pyetur në lidhje me derdhjen e ujërave të zeza në ambientet e jashtme, *(grafiku 10),* 71% e të intervistuarve janë përgjigjur se ka derdhje të ujërave të zeza, 26% janë përgjigjur se nuk ka derdhje të ujërave të zeza dhe 3% janë përgjigjur se nuk e dinë.

Gjithashtu banorët janë pyetur dhe për mënyrën e zgjidhjes së këtyre problemeve si dhe për afatin e zgjidhjes se këtyre problemeve. Dhe nga pyetësori janë parashtruar disa nga këto zgjidhje si: në bashki, e zgjidhim vetë dhe alternative të tjera.
Për rastin kur banorët janë pyetur për kohëzgjatjen e zgjidhjes së problemit nga bashkia, *(grafiku 11),* 40% janë përgjigjur i

9. Sa të kënaqur jeni me largimin e UZ?



10.Ka derdhje të UZ në ambiente jashtë?



11. Sa shpejt zgjidhet problemi nga Bashkia?



duhet mbi 1 javë, 26% janë përgjigjur se e lenë pa zgjidhur, 12% janë përgjigjur brenda ditës, 12 % thonë se i duhen 2 deri në 3 ditë dhe 10% janë përgjigjur në 1 javë.

Në rastin kur banorët e zgjidhin vetë problemin e kanalizimeve, *(grafiku 12)*, 40% janë përgjigjur brenda ditës, 23% janë përgjigjur se duhen 2 deri në 3 ditë, 16% thanë se duhet 1 javë dhe 15 % mbi 1 javë.

Në rastin kur banorët janë pyetur nëse e gjejnë zgjidhjen në qark, *(grafiku 13)*, 41% janë përgjigjur se lihet pa zgjidhur, 17% janë përgjigjur se duhet mbi 1 javë, 12% thonë se zgjidhet në 1 javë, 12% janë përgjigjur se duhen 2 deri në 3 ditë, 12% nuk e dinë dhe vetëm 6% e të intervistuarve thonë se zgjidhet brenda ditës.

12. E zgjidhim vetë problemin e kanalizimeve



13. Në qark



1.3. Pastërtia e qytetit

Në çështjen e menaxhimit të mbetjeve dhe për ofrimin e këtij shërbimi banorët e qytetit u pyetën se si ata e vlerësonin gjendjen e lagjes së tyre, *(grafiku 14)*, i janë përgjigjur me 56% se është e papastër, 30% janë përgjigjur se është e pastër, 13% e të intervistuarve janë përgjigjur se është shumë e papastër dhe vetëm 1 % janë përgjigjur se është shumë e pastër.

Në rastin kur ata e kanë cilësuar lagjen tyre si të papastër ata janë pyetur se cilët janë problemet kryesore që i shqetësojnë, *(grafiku 15)*, 54% e të intervistuarve janë përgjigjur se ka mbeturina dhe plehra, 17% janë përgjigjur se ka ndotje të ndryshme, 15% thonë se ka të tjera efekte dhe 14% janë pa përgjigje.

Gjithashtu banorët janë pyetur për konstatimin e tyre në lidhje me performancën e shërbimit të grumbullimit dhe largimit të mbetjeve nga ana e kompanisë që merret me mbledhjen e mbetjeve të ngurta urbane, *(grafiku 16)*. Nga pyetësorët ka dalë se 52% thonë se nuk i lenë në sasi të mëdha mbetjet, 44% pohojnë se kompania i le pa mbledhur në sasi të konsiderueshme

14. Si është lagjia/rruga juaj nga pastërtia ?



15. Nëse lagjia është e papastër, cili është problemi?



16. Gjatë muajit të fundit, kompania i le pa mbledhur mbetjet në sasi të konsiderueshme?



17. Nëse Po, sa herë keni vënë re që të ndodhë një gjë e tillë?



18. A ka numër mjaftueshëm kazanesh për mbetjet?



19. Gjatë muajit fundit,vihen re erë e keqe, parazitë etj, tek v.grumbullimet ?



mbetjet dhe 4% e të intervistuarve nuk e dinë . Në vijim të pyetjes së mësipërme banorët janë pyetur për frekuencën e mungesës së këtij shërbimi, *(grafiku 17),* janë pa përgjigjur në 30% të intervistuarve se ka ndodhur që kompania i ka lënë mbetjet pa i mbledhur në sasi të konsiderueshme 1 deri në 2 herë,12% janë përgjigjur 3 deri në 5 herë, 11% janë shprehur se kompania i ka lënë më shumë se 5 herë, 3% janë përgjigjur se kjo nuk ka ndodhur kurrë dhe 44% janë pa përgjigje.

Gjithashtu për të kuptuar dhe me mirë arsyen se përse këto vende grumbullimi të mbetjeve të ngurta urbane tejmbushjen banorët janë pyetur për sasinë e kontejnerëve për mbledhjen e mbetjeve dhe për këtë, *(grafiku 18),* 87% u përgjigjën se nuk ka kontejnerë mjaftueshëm, 12% u përgjigjën se ka mjaftueshëm kontejnerë dhe 1% e të intervistuesve janë pa përgjigje.

Kur banorët u kërkuan të përgjigjen në lidhje me erën e keqe, parazitë dhe ndotës të tjerë, tek vend grumbullimet, *(grafiku 19),* 74% e tyre u përgjigjën pozitivisht, 23% e tyre u përgjigjën me jo dhe 3% janë pa përgjigje.

Në pyetjen se ku i hedh familja juaj mbeturinat, *(grafiku 20),* 74% e të intervistuarve janë përgjigjur se i depozitojnë mbetjet e ngurta urbane në kontenieret e vendosura nga bashkia për grumbullimin e mbetjeve, 18% janë përgjigjur në vende të hapura të caktuara, 6% në vende të posaçme betoni, 1% ku të munden dhe 1% është pa përgjigje.

Kur u pyetën në lidhje me mirëmbajtjen e hapësirave publike banorët u kërkuan të përgjigjeshin për shkakëtarët kryesorë të ndotjes me mbetjet ushqimore, *(grafiku 21),* janë përgjigjur me 85% se shkakëtarë janë vetë banorët, me 10% se shkakëtarë janë lokalet dhe restorantet dhe 5% firmat private.

Ndërsa në rastin për ndotjet plastikë *(grafiku 22),* në 42% janë përgjigjur se kjo ndotje vjen nga firmat private, 29 % të intervistuarve kanë thënë se banorët janë shkaktarë dhe 29% janë përgjigjur lokalet dhe restorantet

Lidhur me mbetjet e ndërtimit dhe mbetjet industriale nuk ka pasur përgjigje nga të intervistuarit.

Për pyetjen se kush duhet ta mbajë pastër lagjen, *(grafiku 23),* janë përgjigjur në 53% të rasteve bashkia, në 36% të rasteve qytetarët, 6% firmat private, 4% qeveria dhe 1% janë pa përgjigje.

20. Ku i hedh familja juaj mbeturinat?



21. Mbetje ushqimore



22. Plastike me shumicë



23. Kush duhet të mbajë pastër lagjen



24. A ka në lagjen tuaj park/siperfaqe të gjelbëruar?



25. Nëse nuk ka hapësira të gjelbëruara, PSE?



26. Pasojat që sjell për ju ndërtimi pa leje



1.4. Hapësirat publike

Në lidhje me pyetjen a ka sipërfaqe të gjelbëruar në lagjen tuaj *(grafiku 24),* janë përgjigjur me 96% se nuk ka sipërfaqe të gjelbëruar dhe me 4% se ka sipërfaqe të gjelbëruara

Për ata qytetarë që kanë thënë se nuk ka hapësira të gjelbëruara, pyetjes së dytë sepse ndodh kjo, *(grafiku 25),* u përgjigjën në 59% se nuk ka hapësira të lira, 26% thonë se ka hapësira të lira por nuk investon bashkia, 7% ka pasur një lulishte por është zënë nga ndërtimet, 7% janë pa përgjigje dhe 1% u përgjigjën se ka arsye tjetër.

Për sektorin e ndërtimit pa leje lidhur me pyetjen çfarë efekti kanë për ju ndërtimet pa leje, *(grafiku 26),* u përgjigjën me 72% se ndërtimet kanë zënë sipërfaqet e parqeve dhe hapësirave të tjera publike, 11% ndërtimet kanë dëmtuar pamjen e qytetit, 6% ndërtimet më kanë siguruar mua ose dikujt tjetër nga familja ime me strehim, 6% ndërtimet kanë zënë pronën time private, 4% ndërtimet më kanë siguruar mua ose anëtarit të familjes, punë ose të ardhura dhe 1% ndërtimet kanë zënë sipërfaqet e parqeve dhe hapësirave të tjera publike.

AKSESI NË FURNIZIMIN ME UJË TË PIJSHËM DHE LARGIMIN E UJRAVE TË NDOTURA NË ZONËN FUNKSIONALE DURRËS - REZULTATET

1. REZULTATET E ANKETIMIT QYTETAR

Furnizimi me ujë të pijshëm nga ndërmarrjet shtetërore paraqitet 100% për Katundin e Ri, 98% për Durrësin, 90% për Sukthin, 70% për Rrashbullin dhe 30% për Maminasin dhe Ishmin, (grafiku 1).



Maminas dhe Ishëm paraqesin në vlera të konsiderueshme furnizimin me ujë nga burime të tjera.



Për sa i përket cilësisë së furnizimit me ujë, 50% e qytetarëve në Durrës janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur, ndërsa 62% e qytetarëve në komunat janë aspak të kënaqur dhe deri diku të kënaqur (grafiku 2).

Përqindja më e madhe e intervistuesve nga komunat janë të pakënaqur nga shërbimi i furnizimit me ujë, në ndryshim me përqindjen e mendimit të të intervistuarve në Durrës.



Të pyetur për pajisjen me depozita, pompa uji dhe matës, 90% në Durrës dhe 92% në Komuna përdorin depozita, 84% në Durrës dhe 78% në Komuna përdorin pompa uji, kurse pajisja me matësa uji është 94% për Durrësin dhe 76% për Komunat(grafiku3)

Maminas dhe Durrës qytet përdorin më

pak depozitat e ujit, Sukthi dhe Nishtulla përdorin më pak pompat e ujit.
Matësat: Brenda Durrësit, Plazhi është zona me më pak matës (70%), kurse në lidhje me komunat: Sukthi ka 90% matës, pjesa tjetër 40% - 60% e pajisur.

Tarifat dhe pagesat



Të pyetur për tarifat dhe pagesat, 94% e qytetarëve në Durrës paguajnë dhe 46% e tyre mendojnë se janë të përballueshme, ndërkohë që vetëm 4% pranojnë shtesë në tarifë për rritjen e shërbimeve të ujit. Ndërkohë 76% e qytetarëve në Komunat paguajnë dhe 38% e tyre mendojnë se janë të përballueshme, ndërsa vetëm 10% e tyre pranojnë shtesë në tarifë për rritjen e shërbimeve të ujit. (grafiku4).

Durres perqindja e qytetarëve që paguajnë është më e lartë se në komuna sikurse dhe mendimi që është tarifë e përballueshme.

Furnizimi alternativ me ujë



Në rastin e furnizimit alternativ me ujë, komunat paraqesin përqindje të lartë të përdorimit të puseve private, kurse Durrësi është në nivelin 22%. Maminasi dhe Durrësi përdorin dhe burime natyrore, dhe në përqindje më të vogël është blerja e ujit për Maminasin, Durrësin dhe Sukthin (grafiku5).

Cilesia e ujit te furnizuar



Në lidhje me cilësinë e ujit, qytetarët u pyetën për aromën, shijen, ngjyrën, presionin dhe temperaturën e ujit. Nga anketimi rezulton se Katundi i Ri paraqet

situatën më të mirë, kur problem për të mbetet presioni i ujit dhe temperatura (50% e të intervistuarve). Ndërkohë, për komunat e Sukthit dhe Ishmit vlerat luhaten 40% - 70% përsa i përket shijes, aromës dhe presionit, dhe 20%-50% përsa i përket presionit dhe temperaturës.
Me problematike mbetet situata për Maminasin me vlera 90% dhe Rrashbullin me vlera 70% përsa i përket shijes, aromës dhe presionit, Maminasi 80% për ujin me ngjyrë dhe 70% për temperaturën, Rrashbulli 50% për ujin me ngjyrë. Durrësi paraqet vlera 32% deri në 46% për shqetësimet në lidhje me parametrat e dhëna (grafiku6).

Përqindjet e dhëna i referohen përgjigjeve gjithmonë, shpesh dhe ndonjëherë. Në lidhje me erën e keqe shumica e përgjigjeve është ndonjëherë, kurse për shijen e keqe shumica i referohet shpesh.

2. PASQYRIM I NIVELIT TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË

2.1 Furnizimi me ujë Durrës

Ndërmarrja	Prodhim	Shërndarje	Largim i ujrave të përdorur	Mbulimi	Detaje te mbulimit	Ujra nëntokësorë të matur m3	blerje e ujit me shumice - trajtuar	Gjatesia totale e shperndarje KM
UKD	Po	Po	Po	Të gjithë zonën	Durres, Bashkia Sukth, Manz, Shijak, Komunat: Katundi i Ri, Rrashbull, Ishëm, Maminas, Gjepalaj, Xhafzotaj, Fushë Kuqe, Preze. Fshatrat: Shetel, Çezmelli, Eminas	27,000,000	360,000	640

Popullsia	Mbuluar	Sherbyer	%	Krahasuar me anketimin qytetar
	330,000	280,000	85%	81%
Lidhjet	total	Matur	%	
funksionale	76,000	50,000	66%	75%
Shtepiake	71,000	45,000	63%	

2.1 Furnizimi me ujë Maminas

Ndërmarrja	Prodhim	Shërndarje	Largim i ujrave të përdorur	Mbulimi	Detaje te mbulimit	Ujra nëntokësorë të pamatur m3	Gjatesia totale e shperndarjes KM
UKD Shijak (MAMINAS)	Po	Po	Jo	Të gjithë zonën	Vore Marikaj (vetem biznese)	180,000	10

Popullsia	Mbuluar	Sherbyer	%	Krahasuar me anketimin qytetar	cilesia e sherbimit	Burime te tjera te perdorur nga qytetaret
	20,000	7,500	38%	30%	40% aspak te kenaqur	60%
Lidhjet	total	Matur	%		te tjera	Puse
Funksionale	320	175	55%	50%	900	200
Shtepiake	320	175	55%			

REKOMANDIME

• Furnizimi me ujë të pijshëm është i pamjaftueshëm për të përballuar nevojat e qytetarëve. Bashkia duhet të evidentojë përmes vrojtimit në terren arsyet e kësaj situate, të përcaktojë plane konkrete veprimi për përmirësimin e saj, të planifikojë investime më të mëdha në këtë fushë në bashkëpunim me qeverinë qendrore. Gjithashtu ajo duhet të bashkëpunojë me ndërmarrjen ujësjellës kanalizime për të gjetur rrugë dhe mundësi për përmirësimin e shërbimit përmes menaxhimit më efektiv dhe efiçent. Nga ana tjetër, ndërmarrja ujësjellës- kanalizime duhet të ndërhyjë më shpejt për evidentimin dhe riparimin e defekteve që sjellin probleme në furnizimin me ujë të pijshëm dhe që ndikojnë në cilësinë e tij.

• Ndërgjegjësimi i qytetarëve për higjenizimin e depozitave, mosshpërdorimin e ujit të pijshëm, për të paguar tarifat e shërbimit të furnizimit me ujë duhet të jetë i vazhdueshëm. Nga ana tjetër është e nevojshme të realizohet një studim i tarifës së ujit, si një çështje komplekse sociale dhe ekonomike, dhe të merren parasysh mundësi lehtësimi për familjet në nevojë. Është i nevojshëm një kontroll dhe monitorim i firmave të kontraktuara, pasi materialet që përdorin për tubat e furnizimit të ujit ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë te cilësia e ujit.

• Situata duhet përmirësuar sidomos në ndërhyrjen në infrastrukturën e shërbimit të largimit të ujerave të zeza duke e përmirësuar atë më anë të ndërhyrjes së menjëhershme nga ana e punonjësve të shoqërive ujësjellës kanalizime.

• Pastërtia e Qytetit: Vlerësimi negativ i qytetarëve mbi gjendjen e mjedisit në qytetin e Durrësit duhet të tërheqë vëmendjen e sektorit përgjegjës në këtë bashki, por njëkohësisht dhe të Agjencisë Rajonale të Mjedisit e cila ushtron veprimtarinë e saj në qarkun e Durrësit.

KESHILLI BASHKIAKËT
DURRES
SOT PËR TË ARDHMEN
QENDRA PËR ZHVILLIM KOMUNITAR
RRJETI I QENDRAVE
ZHVILLIM KOMUNITAR

• Situata mjedisore shfaq probleme të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe afatgjata për të ndryshuar gjendjen. Bashkia duhet të adaptojë plane të ndërhyrjes në mjedis dhe duhet të reflektojë në buxhetet e tyre aktivitete konkrete që do të çonin në përmirësimin e kësaj situate në disa drejtime. Gjithashtu ajo duhet të marrë nisma dhe të mbështesë me shumë projekte që do të ndihmonin në përmirësimin e situatës mjedisore në këtë qytet. Përveç burimeve lokale mund të shfrytëzohen edhe burimet e qeverisë qëndrore dhe të tjera, (donatorë, komuniteti i biznesit etj.) për të përmirësuar cilësinë e mjedisit.

• Në mënyrë që shërbimi i pastrimit të qytetit të përmirësohet duhet të shihen standardet e shërbimit dhe të zbatohen ato nga ndërmarrjet që realizojnë pastrimin e qytetit. Sektorët e shërbimeve në bashkinë e Durrësit mund të përcaktojnë standarde të reja, plotësimi i të cilave do të kërkonte vendosjen e tarifave me të larta, si dhe të organizojë fushata ndërgjegjësuese me komunitetin për këtë qëllim.

• Hapësirat publike: Sektorët përkatës në bashkinë e Durrësit duhet të mendojnë rrugë dhe programe specifike për të përmirësuar cilësinë e mjedisit në qytetin e tyre, kjo për pasojë se shumë qytetarë mendojnë se sipërfaqet e gjelbëruara mungojnë ose që ato janë të pamjaftueshme, dhe kjo ka sjelle pakënaqësi tek banorët.

• Përveç fondeve që mund të grumbullohen nga tarifa e gjelbërimit që ka vendosur bashkia, duhet të merret nisma për me shumë projekte të partneritetit publik-privat dhe bashkëpunime me OJF-të që punojnë në fushën mjedisore.

REAL

Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të REC apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e këtij publikimi.

QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri

SWEDEN

SOT PËR TË ARDHMEN

Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen" është një organizatë lider në Shqipëri për mobilizim dhe fuqizim të komuniteteve në nevojë. E udhëhequr nga vizioni i organizatës "Sot për të Ardhmen" dhe duke përdorur metoda inovative dhe gjithëpërfshirëse, QZHK "Sot për të Ardhmen" ka krijuar përqasje të suksesshme të fuqizimit gjinor; vullnetarizmit; aktivizmit; mbrojtjes së mjedisit; ndërmjetësimit për punësim; shërbimeve, përfshirjes dhe mobilizimit komunitar.

QZHK "Sot për të Ardhmen" - Durrës
L.17, Rr. "Rinia Durrsake, Skolina 5, ish-Këneta, Durrës, Shqipëri
Kutia Postare **(POBOX)** 537 / **Tel/Fax** +355 52 90 10 71 / **Tel:** +355 52 90 10 70 / +355 42 30 24 10
e-mail: info@cdc-tff.org

www.facebook.com/AlbanianCommunityCentre
www.youtube.com/SotPerTeArdhmen
www.twitter.com/SotPerTeArdhmen
www.cdc-tff.org

SENiOR·A
Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri

ISBN: 978-9928-4302-1-2
9 789928 430212